



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’ Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Termt e Referencës

Pozicioni:	Ndihmës projekti
Vendodhja:	Shqipëri
Fillimi i Punës:	28.10.2021
Mbarimi i Punës:	15.12.2021
Kohëzgjatja:	35 ditë punë

Projekti: Ditët e sotme burgjet janë mjedise multi-etnike. Diversiteti etnik dhe kulturor i të burgosurve paraqet sfida të shumëfishta për stafin e vijës së parë në burgje, të cilët përballen më kultura e gjuhë të “panjohura”, fenomenin e nën-kulturës dhe episode të mundshme radikalizimi dhe ekstremizmi. Menaxhimi i aspekteve multi-kulturore në ambientet e burgjeve është një çështje prioritare në legjislacionin e BE-së, siç theksohet edhe në Rekomandimin Cm/ Rec (2012)12 të Këshillit të Ministrave. Nisur nga kjo ka lindur nevoja që stafi i burgjeve të marrë trajnimet e duhura për tu përballur me nevojat dhe të drejtat e të burgosurve të huaj. Në këtë kuadër, projekti 2 vjeçar “B-ComPetent – Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe” ka për qëllim të kontribuojë në aplikimin koherent dhe efektiv të legjislacionit dhe standardeve të BE lidhur me trajtimin e të burgosurve të huaj nëpërmjet ndërtimit dhe implementimit të një programi të tipit “train-the-trainers” (ballë-për-ballë dhe e-learning), kombinuar me praktikën më të mira, aksione për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjeteve praktike multi-gjuhësore. Avokati i Popullit në bashkëpunim me gjashtë partner, janë duke implementuar projektin nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*” i bashkë financuar nga Programi i Drejtësisë së BE (2014-2020).

Objektivi

Avokati i Popullit kërkon të rekrutojë një ndihmës projekti (project assistant), i cili do të angazhohet në kryjen e të gjitha aktiviteteve të mbetura, si dhe hartimin e raporteve sipas kuadrit të projektit nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*”.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Avokati i Popullit, kërkon që ndimësi i projektit (project asistent) të jetë i aftë të kryej:

- Shkrim raportit narrativ;
- Kontrollin e aktiviteteve të kryera dhe përputhshmërinë me paketat e punës WP1, WP2, WP3, WP4;
- Kontrollin e dokumentacionit justifikues për secilin aktivitet të kryer deri më tani dhe hartimin e dokumentacionit justifikues për aktivitetet e mbetura dhe raportin përfundimtar të projektit;
- Ofrimin e asistencës për përzgjedhjen e ekspertëve në projekteve;
- Bashkëpunim me sektorin e financës dhe prokurimeve për mbarëvajtjen financiare të projektit;
- Sigurimi i respektimit të detyrimeve të kontratës dhe linjave të buxhetit;
- Përmbushja e detyrave administrative, mbajtja e komunikimit me donatorët dhe grupet e interesit;
- Raportimi pranë donatorit dhe Avokatit të Popullit.

Kriteret e veçanta

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat juridike dhe/ose ekonomike
- Të ketë eksperiencë të gjatë në manaxhimin e projekteve të ndihmës huaj;
- Të ketë njohuri lidhur me objektin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit;
- Vlerësohet nëse eksperti ka pasur bashkëpunime të tjera të mëparshme me institucionin e Avokatit të Popullit;
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar;
- Preferohet të ketë njohuri të një gjuhë tjetër të Bashkimit Europian;
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi;
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial.

Aplikanti duhet të dorëzoj:

1. Letër motivimi
2. Curriculum vitae
3. Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin.

Afati i aplikimit: 26 Tetor 2021

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

Adresa: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 2, Tiranë